



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26 Qershor 2023

Nr: 673

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 334 ID DHE 348 ID PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 26 Qershor 2023

Nr: 673
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 334 ID dhe 348 ID.”

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 19.04.2023, është administruar shkresa me nr. 3964., nga z. Ivi Kaso, i regjistruar me nr. 334 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në datën 17.4.2023 në media u publikuan foto dhe video ndërsa djali i kandidatit të PS për bashkinë Has Halit Mulaj me punonjës shtetërorë (Shkëlqim Muneka), me automjete në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, shpërndajnë ndihma ushqimore në këmbim të votave në Has, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe urdhërit nr. 46, datë 22.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”*.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 25.4.2023, është administruar është administruar denoncimi, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), i regjistruar me nr. 348 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Konkretisht, fjala e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të 19 prillit 2023, në gjykimin e KRIIK është një fjalë me natyrë të pastër elektorale. Përgjatë gjithë fjalimit, z. Veliaj ka bërë një numër komentesh me natyrë të qartë elektorale, duke komentuar negativisht subjekte zgjedhore konkurrencte në këto zgjedhje (konkretisht në lidhje me Koalicionin “Bashkë Fitojmë”), duke komentuar elementë të programit elektorale të kandidatit për Kryetar Bashkie të po këtij Koalicioni, madje edhe duke u shprehur në lidhje me pritshmëritë e rezultatit zgjedhor në favor të tij. Për më tepër, në një numër të komenteve të kryera është përdorur një gjuhë denigruese si dhe sulme personale. Theksohet se, mbledhjet e Këshillit Bashkiak të Tiranës janë mbledhje të institucionit të Bashkisë së Tiranës dhe z. Veliaj ishte në këtë mbledhje në funksionin e tij institucional si Kryetar i Bashkisë, dhe jo si kandidat. Pra komentet e kryera në këtë mbledhje përbëjnë përdorim të një eventi institucional për fushatë elektorale. Për më tepër, mbledhja e djeshme e Këshillit Bashkiak ishte një mbledhje e transmetuar gjerësisht në media. Përveçse e transmetuar në kohë reale në faqen e Bashkisë Tiranë në Facebook (çka përbën edhe një tjetër mënyrë se si burimet institucionale janë përdorur për efekte fushate) apo të tjera faqe në rrjete sociale, ajo është transmetuar po në kohë reale nga së paku 5 televizione. Kryetari i Bashkisë Tiranë e përdori mbledhjen e djeshme të Këshillit Bashkiak dhe pozicionin e tij zyrtar si Kyebashkiak për të përfutur një avantazh elektorale ndaj konkurrentëve të vet në garë, duke dëmtuar në këtë mënyrë barazinë në garë, në shkelje të parimeve për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, përveçse në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.”*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 334 ID dhe 348 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI